



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 706 / 5 prot

Datë 12.03.2026

V E N D I M
Nr. 392/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 12.03.2026 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Vendim për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Alpha Solutions Group” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-77670-02-27-2026, me objekt “Blerje materiale hidraulike, tubo, pvc, pe, Corrogete”, me fond limit: 9,997,619 (nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e nëntëmbëdhjetë) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 19.03.2026, nga autoriteti kontraktor, Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Pogradec.

Modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-77670-02-27-2026, me objekt “Blerje materiale hidraulike, tubo, pvc, pe, Corrogete”, me fond limit: 9,997,619 (nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e nëntëmbëdhjetë) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 19.03.2026, nga autoriteti kontraktor, Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Pogradec.

Ankimues:

Operatori ekonomik “Alpha Solutions Group” SHPK me NIPT L63620402U me adresë Lagjia “29 Mars”, Nr. Pas 15-339, Patos, Fier.

Autoriteti Kontraktor: Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Pogradec.
Adresa: Rruga “Gurasit” Pogradec.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlëra limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 02.03.2026 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-77670-02-27-2026, me objekt “Blerje materiale hidraulike, tubo, pvc, pe, Corrogete”, me fond limit: 9,997,619 (nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e nëntëmbëdhjetë) lekë pa TVSH,

parashikuar për t'u zhvilluar në datën 19.03.2026, nga autoriteti kontraktor, Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Pogradec.

II.2. Në datën 05.03.2026, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2025/6389 dhe me nr. 706/2026 protokollin, i operatorit ekonomik “Alpha Solutions Group” SHPK, nëpërmjetë së cilës kërkohet modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, e më konkretisht ndër të tjera pretendohet si më poshtë vijon:

Shoqeria Alpha Solutions me Nipt L63620402U, me administrator Znj. P. S, me adrese ne Patos, si operator ekonomik i interesuar te marre pjese ne proceduren e prokurimit qe do te zhvillohet nga Autoriteti Kontraktor Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Pogradec sh.a, date 19.03.2026, me objekt Blerje materiale hidraulike, tubo, pvc, pe, Corrogete, me fond limit 9 997 619(nente milion e nenteqind e nentedhjet e shtate mije e gjashteqind e nentembedhjet) leke pa tvsh, pasi u njohem ne daten 02.03.2026 me DST, kriteret e vecanta per kualifikim dhe me specifikimet teknike per produktet e kerkuara, veme re se per disa produkte si:

*TEE Gize DN 160*80*160 mm me dy anaza bronxi dhe Dalja e mesit me Fllanxe pn 16;*

*TEE Gize DN 160*160*160 mm me tre anet unaza bronxi pn 16;*

*TEE Gize 90*90*90 me tre anet unaza bronxi pn 16;*

Bashkues Gize me Fllanxa (Vario) DN 100 mm Pn 16 me kend 10 grade.

Bazuar ne specifikimet teknike ne DST per keto produkte ju veme ne dijeni se prodhuesi i ketyre produkteve eshte kompania Haële Austria Group. Bashkangjitur kesaj ankese do te gjeni edhe kataloget perkates te ketyre produkteve qe perputhen 100% me specifikimet teknike qe ju keni kerkuar. Ju sigurojme se kompania prodhuese Haële Austria Group eshte e vetmja kompani prodhuese qe i prodhon keto produkte me specifikimet teknike qe ju keni kerkuar dhe kjo eshte ne kundershtrim te hapur me LPP-ne. Jeni te lutur te merrni masa te ndryshoni kriteret e vecanta per kualifikim dhe/ose specifikimet teknike te produkteve qe ne kete procedure te kene mundesine te gjitha kompanite qe te konkurojne dhe mos te kete favorizime per operatore te vecante. Kerkesat tuaja per keto produkte kaq specifikisht te detajuara, per mostra per keto produkte si dhe kerkesa per autorizim prodhuesi per keto produkte ne menyre te drejtperdrejt percakton edhe operatorin fitues ne kete procedure. Operatori fitues ne kete procedure do te jete kompania e cila eshte e autorizuar nga Haële Austria Group qe te marre pjese ne kete procedure. Merrni masa qe te hiqni keto produkte nga preventivi dhe/ose te ndryshoni kriteret per kualifikim dhe specifikimet teknike ne menyre qe te jene konform LPP-se.

II.3. Bazuar në nenin 112 pika 3, të ligjit 162/2020, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesit, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Me shkresën nr. 174/18 prot, datë 09.03.2026, me objekt “Vendim për shqyrtim ankese” ardhur nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike protokolluar me tonën me shkresën nr.

706/1 prot., datë 09.03.2026, dhe shkresës nr. 219 prot, datë 09.03.2026, me objekt “Vendimi 174/17 i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës” ardhur nëpërmjet shërbimit postar protokolluar me tonën me nr. 706/2 prot., datë 11.03.2026, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik, informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Alpha Solutions Group” SHPK, nëpërmjet së cilës autoriteti kontraktor ka vendosur pranimin si më poshtë vijonë:

Per sa me poshte po ju percjellim vendimin e komisionit te shqyrtimit te ankeses me nr A/2026/6389 per proceduren me objekt “Blerje materiale hidraulike, tubo, pvc, pe, Corrogete”.

Baza Ligjore: Neni 100, 101, 102 e ne vazhdim, kreu XIV i Ligjit Nr.162/2020, “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar neni 100, 101 i Vendimit të Keshillit të Ministrave Nr. 285, date 19.5.2021, “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, i ndryshuar.

Në pergjigje te ankesës se paraqitur nga shoqeria “Alpha Solutions” sh.p.k., lidhur me dokumentet e tenderit per proceduren e prokurimit me objekt “Blerje materiale hidraulike, tubo, PVC, PE, Corrogete”, Autoriteti Kontraktor paraqet qendrimin si me poshte:

Autoriteti Kontraktor sqaron se hartimi i specifikimeve teknike dhe i kriterëve te veçanta per kualifikim eshte realizuar mbi bazen e nevojave teknike dhe funksionale te institucionit, duke u mbeshtetur ne standardet teknike te perdorura ne sektorin e ujësjelles-kanalizimeve, si dhe ne perputhje me dispozitat e Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe aktet nënligjore ne fuqi.

Në perputhje me nenin 3 të këtij ligji, procedurat e prokurimit publik duhet te zhvillohen duke respektuar parimet e transparences, konkurrences, trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit te operatorëve ekonomikë, si dhe perdorimin me efektivitet te fondeve publike.

Gjithashtu, në perputhje me nenin 36 të Ligjit nr. 162/2020 “Per Prokurimin Publik”, specifikimet teknike duhet të hartohen ne mënyrë të tille që te mos krijojne pengesa te pajustificuara per hapjen e procedurave të prokurimit ndaj konkurrences.

Pas shqyrtimit te pretendimeve te paraqitura në ankesë, dhe ne funksion te garantimit te nje niveli sa më te lartë konkurrence ndërmjet operatoreve ekonomike, Autoriteti Kontraktor vlerëson te arsyeshme pranimin e ankesës dhe rishikimin e disa elementeve te specifikimeve teknike. Ky vendim merret në kuader të permiresimit te dokumenteve të procedures dhe per te garantuar një pjesemarrje sa më te gjerë të operatorëve ekonomikë në procedurë, paparagjykuar faktin se specifikimet teknike jane hartuar mbi bazën e kërkesave standardeve teknike te perdorura në sektor.

Ne kete kuader, Autoriteti Kontraktor do te ndërmarre keto masa:

- Rishikimin dhe saktësimin e disa specifikimeve teknike për produktet e përfshira në procedurë;
- Publikimin e ndryshimeve përkatëse në sistemin elektronik të prokurimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik, për sa me poshte:

Ishte:

TEE BASHKUES GIZE ME DALE BRONZI TË TRE ANËT

TEE me dy dalje me unazë bronzi për kapje për tubat PE 80/100 dhe PVC, për tubat standard PE 80/100 EN 12201, DIN 8074.

Për tubat PVC sipas EN ISO 1452-2.

Për tubat PE me mure të holla (\geq SDR 21) dhe për tubacionet e vakumit.

Trupi Gize: EN-GJS-420-15 sipas EN 1563.

Pluhur epoksi i veshur brenda dhe jashtë: sipas EN 14901 dhe DIN 3476-1 duke marrë në konsideratë kërkesat e cilësisë dhe testimit RAL-GZ 662.

Unazë kapëse prej bronzi për tubat PE dhe PVC.

Bulona çelik inox, cilësi minimale A4.

Unazë vulosëse buzësh Elastomer, EPDM sipas EN 681-1.

Të ketë certifikatën për ujë të pijshëm.

Behet:

TEE me dy dalje me unazë bronzi për kapje për tubat PE 80/100 dhe PVC, për tubat standard PE 80/100 EN 12201, DIN 8074.

Për tubat PVC sipas EN ISO 1452-2.

Për tubat PE me mure të holla (\geq SDR 21) dhe për tubacionet e vakumit.

Unazë kapëse prej bronzi për tubat PE dhe PVC.

Të ketë certifikatën për ujë të pijshëm.

Ishte:

BASHKUESE GIZE ME KEND (VARIO)

Bashkuese me kënd ose (Vario) është një pajisje teleskopike me flanxhe dhe bashkim me fole të integruar, që lejon perkuljen në të gjitha anët deri në një devijim këndor prej 10 gradesh.

Madhesia e flanxhes sipas EN 1092-2 / PN 10 / PN 16.

Vario do të fiksohet në pozicionin e instaluar me anë të një montimi bllokimi tensioni.

Kombinon funksionin e një pjese FF, një pjese berryli të rregullueshme dhe një pjese pershtatëse dhe zgjatuese.

Vario kursen kohë dhe ka mundësi të shumta aplikimi.

Behet:

BASHKUESE GIZE ME KEND ME FLLANHE PN16 DN100

Te prodhuar prej gize sferoidale me rezistence të lartë mekanike.

Te pershtatëshme për linja tubacionesh të ujësjetësve.

Te këne rezistence të mirë ndaj presionit dhe goditjeve hidrunlike, ndaj korozionit.

Te sigurojë lidhje të shëndrueshme dhe hermetike me tubacionin.

Te jenë të pershtatshme për transportin e ujit të pijshëm dhe materialeve të tjera jo agresive.

Për sa më sipër komisioni i ankesës në përputhje me nenin 102 pika vkm nr 285/2021 i ndryshuar pika a vendosi.

Pranimin e plote të ankesës

III

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Alpha Solution Group” ShPK, se: “Shoqeria Alpha Solutions me Nipt L63620402U, me administrator Znj. P. S, me adresë në Patos, si operator ekonomik i interesuar të marrë pjesë në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet nga Autoriteti Kontraktor Shoqeria Rajonale Ujesjetës Kanalizime Pogradec sh.a, datë 19.03.2026, me objekt Blerje materiale hidrulike, tubo, pvc, pe, Corrogete, me fond limit 9 997 619 (nente milion e nenteqind e nentedhjet e shtatë mijë e gjashtëqind e nentëmbëdhjetë) leke pa tvsh, pasi u njohem në datën 02.03.2026 me DST, kriteret e vecanta

per kualifikim dhe me specifikimet teknike per produktet e kerkuara, veme re se per disa produkte si: TEE Gize DN 160*80*160 mm me dy anaza bronxi dhe Dalja e mesit me Fllanxe pn 16; TEE Gize DN 160*160*160 mm me tre anet unaza bronxi pn 16; TEE Gize 90*90*90 me tre anet unaza bronxi pn 16; Bashkues Gize me Fllanxa (Vario) DN 100 mm Pn 16 me kend 10 grade. Bazuar ne specifikimet teknike ne DST per keto produkte ju veme ne dijeni se prodhuesi i ketyre produkteve eshte kompania Haële Austria Group. Bashkangjitur kesaj ankese do te gjeni edhe kataloget perkates te ketyre produkteve qe perputhen 100% me specifikimet teknike qe ju keni kerkuar. Ju sigurojme se kompania prodhuese Haële Austria Group eshte e vetmja kompani prodhuese qe i prodhon keto produkte me specifikimet teknike qe ju keni kerkuar dhe kjo eshte ne kundërshtim te hapur me LPP-ne. Jeni te lutur te merrni masa te ndryshoni kriteret e vecanta per kualifikim dhe/ose specifikimet teknike te produkteve qe ne kete procedure te kene mundesine te gjitha kompanite qe te konkurojne dhe mos te kete favorizime per operatore te vecante. Kerkesat tuaja per keto produkte kaq specifikisht te detajuara, per mostra per keto produkte si dhe kerkesa per autorizim prodhuesi per keto produkte ne menyre te drejtperdrejt percakton edhe operatorin fitues ne kete procedure. Operatori fitues ne kete procedure do te jete kompania e cila eshte e autorizuar nga Haële Austria Group qe te marre pjese ne kete procedure. Merrni masa qe te hiqni keto produkte nga preventivi dhe/ose te ndryshoni kriteret per kualifikim dhe specifikimet teknike ne menyre qe te jene konform LPP-se”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Me shkresën nr. 174/18 prot, datë 09.03.2026, me objekt “Vendim për shqyrtim ankese” ardhur nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike protokolluar me tonën me shkresën nr. 706/1 prot., datë 09.03.2026, dhe shkresës nr. 219 prot, datë 09.03.2026, me objekt “Vendimi 174/17 i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës” ardhur nëpërmjet shërbimit postar protokolluar me tonën me nr. 706/2 prot., datë 11.03.2026, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik, informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Alpha Solutions Group” SHPK, nëpërmjet së cilës autoriteti kontraktor ka vendosur pranimin si më poshtë vijonë:

Per sa me poshte po ju percjellim vendimin e komisionit te shqyrtimit te ankeses me nr A/2026/6389 per proceduren me objekt “Blerje materiale hidraulike, tubo, pvc, pe, Corrogete”.

Baza Ligjore: Neni 100, 101, 102 e ne vazhdim, kreu XIV i Ligjit Nr.162/2020, “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar neni 100, 101 i Vendimit të Keshillit t Ministrave Nr. 285, date 19.5.2021, “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, i ndryshuar.

Në pergjigje te ankesës se paraqitur nga shoqeria “Alpha Solutions” sh.p.k., lidhur me dokumentet e tenderit per proceduren e prokurimit me objekt “Blerje materiale hidraulike, tubo, PVC, PE, Corrogete”, Autoriteti Kontraktor paraqet qendrimin si me poshte:

Autoriteti Kontraktor sqaron se hartimi i specifikimeve teknike dhe i kriterëve te veçanta per kualifikim eshte realizuar mbi bazen e nevojave teknike dhe funksionale te institucionit, duke u mbështetur ne standardet teknike te perdorura ne sektorin e ujësjelles-kanalizimeve, si dhe

ne perputhje me dispozitat e Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe aktet nënligjore ne fuqi.

Në perputhje me nenin 3 të këtij ligji, procedurat e prokurimit publik duhet të zhvillohen duke respektuar parimet e transparencës, konkurrencës, trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit të operatorëve ekonomikë, si dhe përdorimin me efektivitet të fondeve publike.

Gjithashtu, në perputhje me nenin 36 të Ligjit nr. 162/2020 “Per Prokurimin Publik”, specifikimet teknike duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të mos krijojnë pengesa të pajustificuara për hapjen e procedurave të prokurimit ndaj konkurrencës.

Pas shqyrtimit të pretendimeve të paraqitura në ankesë, dhe në funksion të garantimit të një niveli sa më të lartë konkurrence ndërmjet operatorëve ekonomikë, Autoriteti Kontraktor vlerëson të arsyeshme pranimin e ankesës dhe rishikimin e disa elementeve të specifikimeve teknike. Ky vendim merret në kuader të përmirësimit të dokumenteve të procedurave dhe për të garantuar një pjesëmarrje sa më të gjerë të operatorëve ekonomikë në procedurë, paparagjykuar faktin se specifikimet teknike janë hartuar mbi bazën e kërkesave standardeve teknike të përdorura në sektor.

Në këto kuader, Autoriteti Kontraktor do të ndërmarre këto masa:

- Rishikimin dhe saktësimin e disa specifikimeve teknike për produktet e përfshira në procedurë;
- Publikimin e ndryshimeve përkatëse në sistemin elektronik të prokurimit, në perputhje me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik, për sa më poshtë:

Ishte:

TEE BASHKUES GIZE ME DALE BRONZI TË TRE ANËT

TEE me dy dalje me unazë bronzi për kapje për tubat PE 80/100 dhe PVC, për tubat standard PE 80/100 EN 12201, DIN 8074.

Për tubat PVC sipas EN ISO 1452-2.

Për tubat PE me mure të holla (\geq SDR 21) dhe për tubacionet e vakumit.

Trupi Gize: EN-GJS-420-15 sipas EN 1563.

Pluhur epoksi i veshur brenda dhe jashtë: sipas EN 14901 dhe DIN 3476-1 duke marrë në konsideratë kërkesat e cilësisë dhe testimit RAL-GZ 662.

Unazë kapëse prej bronzi për tubat PE dhe PVC.

Bulona çelik inox, cilësi minimale A4.

Unazë vulosëse buzësh Elastomer, EPDM sipas EN 681-1.

Të ketë certifikatën për ujë të pijshëm.

Behet:

TEE me dy dalje me unazë bronzi per kapje per tubat PE 80/100 dhe PVC, per tubat standard PE 80/100 EN 12201, DIN 8074.

Per tubat PVC sipas EN ISO 1452-2.

Për tubat PE me mure të holla (\geq SDR 21) dhe per tubacionet e vakumit.

Unazë kapëse prej bronzi per tubat PE dhe PVC.

Të ketë certifikatën per ujë te pijshëm.

Ishte:

BASHKUESE GIZE ME KEND (VARIO)

Bashkuese me kënd ose (Vario) eshte nje pajisje teleskopike me flanaxhe dhe bashkim me fole te integruar, që lejon perkuljen ne te gjitha anët deri ne nje devijim këndor prej 10 gradesh.

Madhesia e flanaxhes sipas EN 1092-2 | PN 10 / PN 16.

Vario do të fiksohet ne pozicionin e instaluar me anë te nje montimi bllokimi tensioni.

Kombinon funksionin e nje pjese FF, nje pjese berryli te rregullueshme dhe nje pjese pershtatese dhe zgjatuese.

Vario kursen kohë dhe ka mundësi te shumta aplikimi.

Behet:

BASHKUESE GIZE ME KEND ME FLLANHE PN16 DN100

Te prodhuar prej gize sferoidale me rezistence te larte mekanike.

Te pershtateshme per linja tubacionesh te ujesjellesve.

Te kene rezistence te mire ndaj presionit dhe goditjeve hidrunlike, ndaj korozionit.

Te siguroje lidhje te shendrueshme dhe hermetike me tubacionin.

Te jene te pershtatshme per transportin e ujit te pijshem dhe materialeve te tjera jo agresive.

Per sa me siper komisioni i ankeses ne perputhje me nenin 102 pika vkm nr 285/2021 i ndryshuar pika a vendosi.

Pranimin e plote te ankeses

III.1.2. Neni 30 i LPP-së parashikon shprehimisht se: “Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera”.

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se: Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën dhe nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik, brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar dhe vazhdon procedurën për pjesën tjetër.

Në rastin konkret, Komisioni gjykon, se lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues përsa i përketë rishikimit të specifikimeve teknike, KPP konstaton, se autoriteti kontraktor, në kthimin e përgjigjes të ankesës së operatorit ekonomik si më sipër cituam, rezulton, se e ka pranuar pretendimin në lidhje me specifikimet teknike. Duke qenë, se pretendimi i mësipërm i operatorit ekonomik ankimues është pranuar nga ana e autoritetit kontraktor, KPP do të mbyllë shqyrtimin e çështjes në lidhje me këto pretendime të operatorit ekonomik ankimues pasi gjykon, se KSHA në trajtimin e ankesës së ankimuesit rezulton ta ketë pranuar pretendimin. Sa më sipër, referuar nenit 115 të Ligjit Nr. nr. 162/2020 “Për

Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, vendos të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Alpha Solutions Group” SHPK dhe do të vazhdojë procedurën e shqyrtimit në themel për pretendimet e tjera të paraqitura në ankesë.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes “Alpha Solutions Group” SHPK se: “Shoqeria Alpha Solutions me Nipt L63620402U, me administrator Znj. P. S, me adrese ne Patos, si operator ekonomik i interesuar te marre pjese ne proceduren e prokurimit qe do te zhvillohet nga Autoriteti Kontraktor Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Pogradec sh.a, date 19.03.2026, me objekt Blerje materiale hidraulike, tubo, pvc, pe, Corrogete, me fond limit 9 997 619(nente milion e nenteqind e nentedhjet e shtate mije e gjashteqind e nentembedhjet) leke pa tvsh, pasi u njohem ne daten 02.03.2026 me DST, kriteret e vecanta per kualifikim dhe me specifikimet teknike per produktet e kerkuara, veme re se per disa produkte si: TEE Gize DN 160*80*160 mm me dy anaza bronxi dhe Dalja e mesit me Fllanxhe pn 16; TEE Gize DN 160*160*160 mm me tre anet unaza bronxi pn 16; TEE Gize 90*90*90 me tre anet unaza bronxi pn 16; Bashkues Gize me Fllanxha (Vario) DN 100 mm Pn 16 me kend 10 grade. Bazuar ne specifikimet teknike ne DST per keto produkte ju veme ne dijeni se prodhuesi i ketyre produkteve eshte kompania Haële Austria Group. Bashkangjitur kesaj ankese do te gjeni edhe kataloget perkates te ketyre produkteve qe perputhen 100% me specifikimet teknike qe ju keni kerkuar. Ju sigurojme se kompania prodhuese Haële Austria Group eshte e vetmja kompani prodhuese qe i prodhon keto produkte me specifikimet teknike qe ju keni kerkuar dhe kjo eshte ne kundërshtim te hapur me LPP-ne. Jeni te lutur te merrni masa te ndryshoni kriteret e vecanta per kualifikim dhe/ose specifikimet teknike te produkteve qe ne kete procedure te kene mundesine te gjitha kompanite qe te konkurojne dhe mos te kete favorizime per operatore te vecante. Kerkesat tuaja per keto produkte kaq specifikisht te detajuara, per mostra per keto produkte si dhe kerkesa per autorizim prodhuesi per keto produkte ne menyre te drejtperdrejt percakton edhe operatorin fitues ne kete procedure. Operatori fitues ne kete procedure do te jete kompania e cila eshte e autorizuar nga Haële Austria Group qe te marre pjese ne kete procedure. Merrni masa qe te hiqni keto produkte nga preventivi dhe/ose te ndryshoni kriteret per kualifikim dhe specifikimet teknike ne menyre qe te jene konform LPP-se”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.2. Në shtojcën 8/2 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” pikën 2.3.3 “Kapaciteti teknik” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin kualifikues, si më poshtë vijon:

2.3.3. OE ofertues duhet të paraqesë **Autorizim Prodhuesi** ose **distributor zyrtar** për mallrat objekt prokurimi. Në rast paraqitje të autorizimit nga distributori i autorizuar, operatori ekonomik duhet të provojë me dokument, lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

III.2.3. Në shtojcës 6 “Formulari i Specifikimeve Teknike”, të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar, si më poshtë vijon:

Rakorderite Polipropilen

Rakorderite sherbejne per bashkimin dhe pershtatjen e tubave ose rakorderive plastike me permasa te ndryshme. Trupi i rakorderive te jete material Polipropilen me rezistence mekanike te larte. Produktet duhet te jene te bombarduara me rreze ultraviolet ne menyre qe mos te krijojne alga ose baktere. Gjithashtu keto rakorderi nuk duhet ne asnje menyre te krijojne mikroorganizma ne uje te pijshem. Siperfaqja e brendshme e produkteve duhet te jete homogjene dhe nuk duhet te jete poroze. Produktet nuk duhet te permbajne asnje tip substance qe ndryshojne shijen ose eren e ujit. Presioni I punes te jete 16 bar (ose me I larte). Ndryshimi ne dimensionet e produkteve te jete maksimumi ± 0.5 mm nga dimensionet e kerkuara nga AK.

Tuba te brinjezuar (korroget)

Tubat e brinjezuar duhet te jene te strukturuar prej polietileni me densitet te larte. Duhet te jene te forte ne menyre qe te mos pesojne carje apo fryrje. Tubat e brinjezuar duhet te jene te prodhuar ne ate menyre qe bashkimi i tyre te behet sipas metodes nje manikote dhe 2 guarnicione.

Bashkues (Komping)

Bashkueset sherbejne per te bashkuar ose lidhur tubo PE, PVC, gize , cimento, celiku, me fibra xhami etj.. ndermjet tyre. Bashkueset duhet ofrojne garanci dhe siguri te bashkimit te tubove me ane te elementeve te ndryshem shtese qe kane ne sektorin e mberthimit dhe shtrengimit te tubove. Bashkueset duhet te ofrojne nje tolerance midis dy aneve te bashkimit te tubove prej 8 gradesh ose me te larte, pa krijuar asnje problem. Gominat izoluese te bashkueses duhet te jete EPDM per perdorim per uji te pijshem . Bashkueset duhet te kene presion pune 16 bar ose me te larte. Permasat e bashkueseve universale perkatesisht sipas preventivit. Te dy krahet e bashkueses duhet te jene me gomine.

Rakorderite Xingato

Keto rakorderi te sherbejne per lidhjen dhe/ose degezimin e nje tuboje ose rakorderie me ato tubo ose rakorderi te tjera me permasa te njejta ose te ndryshme. Rakorderite duhet te jene material xingato. Forca qe ajo duhet t'i rezistojne eshte minimalisht 35000 N/cm² pa u deformuar, dhe te kene rezistencen **shkalle formimi te pakten 210 HB**. Rakorderite duhet te jene te mbuluar me zink ne sasi minimalisht 450gr/m². Shtresa e zinkut duhet te jete minimumi 65µm. Presioni qe duhet te durojne te jete **minimumi 25 bar** ne temperaturen nga -20°C deri ne 100 °C. Permasat e rakorderive perkatesisht sipas preventivit.

Fasheta PP

Fashetat sherbejne per krijimin e daljeve te sigurta ose linjave te reja ne tubat PE-HD sipas kerkesave. Keto fasheta duhet te jene me rezistence mekanike te larte dhe trupi i tyre te jete material Polipropilen. Fashetat PP përveç se duhet te suportojne presionin **16 bar**. Ndryshimi ne dimensionet e produktevete të jetë **maksimumi ± 0.5 mm** nga dimensionet e kerkuara nga AK. Qe te moskrijojne alga ose baktere, produktet duhet te jene te bombarduara me rreze ultraviolet. Rakorderite duhet te kene nje siperfaqe te brendshme homogjene dhe nuk duhet te jete poroze. Shija dhe era e ujit duhet te mos ndryshoje ne menyre absolute, pra keto rakorderi nuk duhet te permbajne asnje tip substance qe mund te ndikojne ne to. Keto fasheta me kompresion duhet te jene me unaze perforcuese po ashtu te galvanizuar.

Tubot Hdpe

Tuba polietileni me dendësi të lartë. Tubat të kenë një koeficient sigurimi minimalisht 1.20. Materialet e përdorura për prodhimin e tubave të jene jo toksike dhe të mos ndikojnë në cilësinë e ujit (mos t'i japin atij as erë as shije). Të jenë fleksibël dhe me rezistencë ndaj vibrimeve dhe goditjeve sizmike, për tu përshtatur me relievin e tokës. Të jenë rezistent ndaj rrezeve ultraviolet dhe ndaj temperaturave -25 derinë 55°C. Të kenë rezistencë të lartë ndaj gërryerjes dhe jetegjatesi te pakten 50 vjet. Pamja e jashtme: të kenë siperfaqe të lëmuar dhe pa dëmtime, prerja fundore e tubit duhet të jetë e pastër dhe në kënd të drejtë me qendrën e tubit. Permasat dhe presionet e punes se tubove perkatesisht sipas preventivit.

Fasheta Riparuese

Fashetat riparuese te jene inoks. Gomina te jete e ngjitur me fasheten e inoksit me ngjites te perforcuar me fibra xhami per te pasur jetegjatesi dhe qendrueshmeri ndaj temperaturave te larta dhe lageshtise gjate montimit. Goma e perdorur ne fasheten e inoksit duhet te jete cilesi shume e larte sepse ka kontakt te drejtperdrejt me ujin e pijshem prandaj ajo duhet te jete per perdorim per uji te pijshem dhe te duroje temperatura deri 150 °C. Te mund te instalohen edhe nen presion pa pasur probleme (pjesa e daljes se filetuar te jete me tap qe mos te lejoj rrjedhjen e ujit deri ne momentin e deshiruar).

Tuba PVC

Tubat duhet te jene prej polivinil kloridi te paplastifikuar Presioni I punes se tyre duhet te jete minimum 16 bar. Ata duhet te kene rezistence dhe jetegjatesi te larte, ne menyre qe te mos shformohen apo demtohen. Cdo tub duhet te jete I pajisur me manikota te formuara ne skaje dhe te shoqerohen me guarnicione ne menyre qe te mos kete rrjedhje kur te behet bashkimi I tyre.

Fllanxhe adaptor

Fllanxhe adaptoret ose koplimgjet me fllanxhe ose dhe sic njihen ndryshe fllanxh adaptor universal (taolip etj.) perdoren per te lidhur tubin me rakorderi me fllanxhe, temperatura e punes se ketyre fllanxh adaptoreve duhet te jete 0°C deri ne +60°C (pranohet edhe diapazon me I gjere qe perfshijne diapazonin e kerkuar). Ata duhet te jene te veshur me puder epokside

me nje trashesi minimalisht 250 μm . Presioni I punes se tyre duhet te jete PN16 ose me I larte. Devijimi kendor I tyre mos te jete me shume se 5°. Bulonat e ketyre koplingleve me fllanxe duhet te jene prej materiali celik karboni 8.8 dhe te jene te galvanizuar ne te nxehte. Gjithashtu fundet e tyre duhet domosdoshmerisht te jene te mbrojtur me kapak plastik.

Saracineska bronxi F

Saracineskat prej bronxi duhet te jene me leve, te punojne ne presion minimumi 30 bar dhe ne temperature -15°C deri $+110^{\circ}\text{C}$. Saraçineskat duhet të kenë mbyllje sferike me kalim të integruar dhe hapje pozicionale. Si trupi dhe komponentët e tjeter te saraqineskes duhet te jene prej bronxi. Ne saraqineske duhet te jete e shenuar te dhenat baze si madhesia e saraqineskes, emri I kompanise prodhuese ose ndonje shenje e markes etj. Te jene te certifikuara per perdorim per uji te pijshem.

Permasat e Saraçineskave te kerkuara ne preventive jane:

Saracineska 2" ta kete gjatesine minimumi 100mm. Gjatesia totale e pjeseve te filetuara te jete minimumi 35mm, pra minimumi 17.5mm nga secili krahe. Leva e saraqineskes te jete minimumi 140mm dhe lartesia totale e saraqineskes te jete minimumi 110mm.

Saracineska 1 1/2" ta kete gjatesine minimumi 85mm. Gjatesia totale e pjeseve te filetuara te jete minimumi 33mm, pra 16.5 mm nga secili krahe. Leva e saraqineskes te jete minimumi 140mm dhe lartesia totale e saraqineskes te jete minimumi 100mm.

Saracineska 1 1/4" ta kete gjatesine minimumi 75mm. Gjatesia totale e pjeseve te filetuara te jete minimumi 31mm, pra 15.5mm nga secili krahe. Leva e saraqineskes te jete minimumi 110mm dhe lartesia totale e saraqineskes te jete minimumi 82mm.

Saracineska 1" ta kete gjatesine minimumi 65mm. Gjatesia totale e pjeseve te filetuara te jete minimumi 29mm, pra minimumi 14.5mm nga secili krahe. Leva e saraqineskes te jete minimumi 98mm dhe lartesia totale e saraqineskes te jete minimumi 70mm.

Saracineska 3/4" ta kete gjatesine minimumi 55mm. Gjatesia totale e pjeseve te filetuara te jete minimumi 25mm, pra minimumi 12.5mm nga secili krahe. Leva e saraqineskes te jete minimumi 98mm dhe lartesia totale e saraqineskes te jete minimumi 64mm.

Saracineska 1/2" ta kete gjatesine minimumi 45mm. Gjatesia totale e pjeseve te filetuara te jete minimumi 22mm, pra minimumi 11mm nga secili krahe. Leva e saraqineskes te jete minimumi 80mm dhe lartesia totale e saraqineskes te jete minimumi 51mm.

Saracineska bronxi F

Saracineskat prej bronxi duhet te jene me leve, te punojne ne presion minimumi 20 bar dhe ne temperature -8°C deri $+95^{\circ}\text{C}$. Saraçineskat duhet të kenë mbyllje sferike me kalim të integruar dhe hapje pozicionale. Si trupi dhe komponentët e tjeter te saraqineskes duhet te jene prej bronxi. Ne saraqineske duhet te jete e shenuar te dhenat baze si madhesia e saraqineskes, emri I kompanise prodhuese ose I markes etj. Te jene te certifikuara per perdorim per uji te pijshem.

Saracineska 2 1/2" ta kete gjatesine minimumi 134mm. Gjatesia totale e pjeseve te filetuara te jete minimumi 60mm, pra minimumi 30 nga secili krah. Leva e saraqineskes te jete minimumi 224mm dhe lartesia totale e saraqineskes te jete minimumi 132mm.

Saracineska 3" ta kete gjatesine minimumi 130mm. Gjatesia totale e pjeseve te filetuara te jete minimumi 43mm, pra minimumi 21.5mm nga secili krah. Leva e saraqineskes te jete minimumi 244mm dhe lartesia totale e saraqineskes te jete minimumi 145mm.

Saracineska 3" ta kete gjatesine minimumi 130mm. Gjatesia totale e pjeseve te filetuara te jete minimumi 43mm, pra minimumi 21.5mm nga secili krah. Leva e saraqineskes te jete minimumi 244mm dhe lartesia totale e saraqineskes te jete minimumi 145mm.

Saraqineska me flanaxhe

Saraqineskat duhet te jene modeli G me filetim te boshtit qe sherben per kycjen dhe ckycjen e saraqineskes, ne pjesen e brendshme te saraqineskes Temperatura e punes se saraqineskave te jete nga -10°C - +70°C (pranohet edhe diapazon me I gjere qe perfshijne diapazonin e kerkuar). Gjuheza, e cila ben te mundur bllokimin ose jo te rrjedhjes se ujit, duhet te jete e material gize GJS-500-7 (ose ekuivalent) e kapsuluar ne gome EPDM qe lejohet per perdorim per uji te pijshem. Trupi I saraqineskes duhet te jete material gize .Boshti i saraqineskes te jete material I pandryshkshem inoks 1.4034 (ose ekuivalent) qe mos te kete ndikim ne ujin e pijshem per shkak te grryerjes nga uji. Saraqineskat duhet te jene te lyera ose te veshura me boje epokside minimum 250µm. Dado dhe Bulonat te jene material inoks AISI304 (ose ekuivalent), ne menyre qe mos te ndikohen nga erozioni dhe te ndikojne ne mirefunksionimin e saraqineskes.

Manikota Elektrofuzive PN16

Manikotat elektrofuzive duhet të jenë të prodhuara me plastik HDPE 100 te paster dhe jo plastik te riclikuar, për tu përdorur në linjat e furnizimit me ujë të pijshëm. Ato duhet të ketë të shënuara në trup gjithë të dhënat për saldimin. Densitetit i materialit PE ne keto manikota te jete minimumi 0.95g/cm³. Moduli i terheqjes se materialit HDPE te jete testuar dhe me pas gjetur. Po ashtu sforcimi i terheqjes deri ne keputje te materialit hdpe te ketyre manikotave EF, te jete testuar dhe gjetur . Ky material duhet te jete i afte te duroje deri ne 25 Mpa para se te keputet. Permbajtja e te zezes ne karbonin e ketyre elektromanikotave dhe rakorderive PE mos te jete me pak se 2% dhe ky faktor te jete testuar dhe gjetur .Koha e induksionit te oksidimit te manikotave EF ne 210oC mos te jete me pak se 20 minuta dhe kjo te jete testuar dhe gjetur. Keto elektromanikota duhet te jene te forta dhe rezistente ndaj plasaritjeve por nese plasaritja ndodh atehere ato duhet gjithashtu te jene rezistente ne menyre qe keto plasaritje mos te hapen me tej.

Tuba dhe rakorderi PPR

Tubat dhe rakorderite ppr jane material polipropilen dhe kerkohen te jene te perforcuara me fibra xhami. Ato duhet te jene peshe e lehte ne menyre qe transportimi dhe instalimi i tyre te jete sa me i thjeshte. Transmetimi i drites ne keto tuba dhe rakorderi nuk duhet te jete me shume se 0.2% ne menyre qe te mos krijohen alga ne to. Ato duhet te kene qendrueshmeri dhe

rezistence te larte ndaj gerryerjes. Tubat dhe rakorderite nuk duhet te permbajne asnje perberes helmues apo kancerogjen, pra duhet te jene te certifikuar per perdorim ne uje te pijshem. Izolimi i tyre duhet te jene te larte ne menyre qe te parandalohet humbja e nxehtesise. Tubat dhe rakorderite ppr duhet te jene nje koeficient te ulet te percueshmerise termike , jo me shume se 0.25 \ddot{E}/mK .

Fasheta Gize me fileta

Fashetat e gizes me fileta duhet te mund te perdoren ne tuba PE dhe PVC. Cilesia e tyre duhet te jene e larte ne menyre qe te jene jetegjatesi ne perdorim. Presioni I punes qe keto fasheta duhet te suportojne, duhet te jene PN16 ose dhe me I larte. Fashetat duhet te jene te veshur me puder epokside me nje tashesi minimalisht 250 μm . Diapazoni I temperatures se punes se ketyre fashetave duhet te jene 0°C deri ne +60°C (pranohet edhe diapazon me I gjere qe perfshijne diapazonin e kerkuar). Fashetat duhet te shoqerohen me bulona prej materiali inoksi ne menyre qe te mos ndryshken

Elektroda

Elektrodat duhet te jene aprovim nga nje ose disa institucione te cilat vertetojne qe ato jane sipas standarteve te bashkimit europian. Perberja kimike e elektrodave duhet te jene sipas vlerave te meposhtme:

Karboni nga 0.65% deri ne 0.72%, Mangani nga 1.45% deri ne 1.5%, Silici te jene maksimumi 0.5%, Fosfori te jene maksimumi 0.02%, Sulfuri dhe Molibdeni te jene maksimumi 0.01% secili, Kromi, Nikeli dhe Bakri te jene me pak se 0.05% secili. Forca qe duhet te duroje saldimi pa pesuar asnje ndryshim ose thyerje duhet te jene 450 N/mm² (ose me e madhe).

Permasat e Elektrodave perkatesisht sipas radhes ne preventive jane:

Elektroda 3.2mm, Elektroda 2.5mm

Elektroda inoksi

Elektrodat duhet te jene aprovim nga nje ose disa institucione te cilat vertetojne qe ato jane sipas standarteve te bashkimit europian. Perberja kimike e elektrodave duhet te jene sipas vlerave te meposhtme:

Karboni nga 0.14% deri ne 0.18%, Mangani nga 4.5% deri ne 7.5%, Silici te jene maksimumi 1%, Fosfori te jene maksimumi 0.04%, Sulfuri te jene maksimumi 0.03%, Kromi te jene nga 18% deri ne 21%, Nikeli te jene nga 7% deri ne 11%, ferrite nga 5% deri ne 10%. Forca qe duhet te duroje saldimi pa pesuar asnje ndryshim ose thyerje duhet te jene 350 N/mm² (ose me e madhe).

Buketona

Buketonat sherbejne per te lidhur matesat me rrjetin shperndares. Duke qene se ato kane kontakt te drejtperdrejt me ujin duhet te jene te certifikuar per uji te pijshem. Per izolim me te

mire te ujit, buketonat duhet te jene te shoqeruar me gominat perkatese, ose ti kene te inkorporuara ne trup. Duhet te jene material bronzi dhe te durojne presion minimalisht 10 bar. Temperatura e punes se tyre te jete nga -20oC deri ne 90oC. Diapazon me I gjere se diapazoni I kerkuar do te pranohet. Buketonet te jene material bronzi , te lejojne mundesine e vendosjes se vules per sigurine , te shoqeruar bashke me gominat, set I kompletuar.

Duke gene se kane kontakt me ujin e pijshem kerkohet certifikate e materialit

- *EN 10204:2004 3.1*
- *Perputhet me RoHS*
- *Ne perputhje me UBA/4MS*

Ne certifikaten e materialeve te tregohen detajet e analizes se buketoneve , te jene brenda normave per uje te pijshem sipas standarteve me lart.

Bulona+Dado

Bulonat dhe dadot te jene material Celik karboni te shkalles 10.9 . Ato duhet te jene hegzagonale. Bulonat dhe dadot duhet te jene plotesisht te filetuara

Kapak Gize

Kapaket e gizes duhet te jene ne forme rrethore. Korniza dhe kapaku duhet te jene material gize. Ndermjete kapakut dhe kornizes duhet te jete nje shtrese elastike pvc ne menyre qe kur kapaku te mbyllet, te puthitet 100% dhe te eliminohen zhurmat.

Matesa mekanik + Buketona 1''

Të jetë i ndjeshëm edhe për rrymat më të vogla. Mekanizëm me vakum. Te jete për ujë të pijshëm dhe ekrani te rrotullohet ne 360°.Te kete te pakten tre vjet garanci-Pothuajse nuk ka nevoje per mirembajtje .Te kete vendin per vendosjen e modulit te leximit ne distance moduli AMR.Per temperaturë e ujit deri në 50°C. Te punoje me presion deri në 16 bar. Te kete Instruksione montimi brenda kutise dhe fletë garancine..Trup i matesit te jete material bronzi e lyer me bojë elektrostatische kunder ndryshkjes dhe me dalje te filetuara Fusha duhet te jete e mbrojtur me ane te nje kapaku dhe te jete e mbyllur direkt ne trupin e matesit per te shmangur cdo lloj nderhyrje te mundshme.Montimi ne rrjetet te jete horizontal .Matesi duhet te shfaqe rezistence te larte ndaj fenomenit te korrozionit dhe ndaj agjenteve te tjere atmosferike. Matesi duhet te jete i pajisur me unaze gomine per te siguruar shkalle te larte hermeciteti apo izolacioni qe te siguroje mbrojtje te plote ndaj elementeve te ndjeshem te matesit.Fillimi i matjes te jete 7 l/h.Kapacitet regjistrimi m3/h 99999/99999,999

Bashkues Gize Per Hpe

Bashkues për tuba PE, PVC. Bashkuesi i gizes të jetë i mbrojtur plotësisht nga korrozioni.

I përshtatshëm për tubat PE 80/100, EN 12201, DIN 8074.

Për tubat PVC sipas EN ISO 1452-2.

Për tubat PE me mure të holla (≥ SDR 21) dhe për tubacionet e vakumit.

Trupi Gize: EN-GJS-420-15 sipas EN 1563.

Pluhur epoksi i veshur brenda dhe jashtë: sipas EN 14901 dhe DIN 3476-1 duke marrë në konsideratë kërkesat e cilësisë dhe testimi RAL-GZ 662.

Trashësia e veshjes: min. 250 µm.

Unazë kapëse prej bronzi për tubat PE dhe PVC.

Bulona çelik inox, cilësi minimale A4.

Unazë vulosëse buzësh Elastomer, EPDM sipas EN 681-1.

Të ketë certifikatën për ujë të pijshëm.

Bashkuese Gize me Kënd (Vario)

Bashkuese me kënd ose (Vario) është një pajisje teleskopike me flanxhë dhe bashkim me fole të integruar, që lejon përkuljen në të gjitha anët deri në një devijim këndor prej 10 gradësh. Madhësia e flanxhës sipas EN 1092-2 | PN 10 / PN 16.

Vario do të fiksohet në pozicionin e instaluar me anë të një montimi bllokimi tensioni.

Kombinon funksionin e një pjese FF, një pjese bërnyli të rregullueshme dhe një pjese përshtatëse dhe zgjatuese.

Vario kursen kohë dhe ka mundësi të shumta aplikimi.

Tee Bashkues Gize me Dale Bronzi të tre Anët

TEE me dy dalje me unazë bronzi për kapje për tubat PE 80/100 dhe PVC, për tubat standard PE 80/100 EN 12201, DIN 8074.

Për tubat PVC sipas EN ISO 1452-2.

Për tubat PE me mure të holla (\geq SDR 21) dhe për tubacionet e vakumit.

Trupi Gize: EN-GJS-420-15 sipas EN 1563.

Pluhur epoksi i veshur brenda dhe jashtë: sipas EN 14901 dhe DIN 3476-1 duke marrë në konsideratë kërkesat e cilësisë dhe testimi RAL-GZ 662.

Unazë kapëse prej bronzi për tubat PE dhe PVC.

Bulona çelik inox, cilësi minimale A4.

Unazë vulosëse buzësh Elastomer, EPDM sipas EN 681-1.

Të ketë certifikatën për ujë të pijshëm.

Fasheta Kavallotta Gize

Trupi i fashetës: EN-GJS-400-15 sipas EN 1563.

Veshje me pluhur epoksi brenda dhe jashtë: sipas DIN 3476-1 dhe EN 14901 duke marrë në konsideratë kërkesat e cilësisë dhe testimi RAL-GZ 662.

Trashësia e veshjes: min. 250 µm.

Poroziteti zero: min. testi i shkëndijës 3000 V.

Ngjitja: min. 16 N/mm².

Guarnicioni i fashetës i bërë nga elastomeri.

Rip i bere nga celik inox I pasivizuar , fortesia 1.5 me mbushje gome elastomeri izoluese unaze mbrojtese.

Fasheta Riparuese Inoksi

Presioni i punës: PN10/16;

Temperatura maksimale: -10°C - +80°C;

Përdorimi: I përshtatshëm për ujë, kanalizime, gaz, naftë etj.

Standardet

Testi: EN 12266-1;

Veshje: EN30667.

Karakteristikat

Kontakt fleksibël; I sigurt dhe i besueshëm;

I fortë dhe antikoroziv; Aplikim i menjëhershëm dhe i përshtatshëm.

Opsionet

- Gjatësia e disponueshme: 100-200-300-400 mm;
- Kapëse: SS420/SS316;
- Guarnicion gome: NBR.

III.2.4. Në shtojcës 7 “Formulari i Sasisë dhe Grafikut të Lëvrimit”, të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar listën dhe sasinë e artikujve objekt prokurimi, si më poshtë vijon:

NR	EMERTIMI I MALLIT	NJESIA	SASIA
1	Adaptor PP dn 25x3/4 pn16	cope	100
2	Adaptor PP dn 32x1 pn16	cope	50
3	Adaptor PP dn 40x1 1/4 pn16	cope	50
4	Adaptor PP dn 50x1 1/2 pn16	cope	30
5	Adaptor PP dn 63x2 pn16	cope	30
6	Adaptor PP dn 110x4 pn16	cope	20
7	Adaptor PP dn 125x5 pn16	cope	20
8	Bashkues PP dn 25 pn 16	cope	500
9	Bashkues PP dn 32 pn 16	cope	300
10	Bashkues PP dn 40 pn 16	cope	100
11	Bashkues PP dn 50 pn 16	cope	50
12	Bashkues (koming) dn 300 ME DHEMBE(NDALUES)	cope	3
13	Bashkues (koming) dn 400 ME DHEMBE(NDALUES)	cope	2
14	Bashkues Gize per tuba PE dhe PVC me unaza Bronxi Dn 160Pn 16	cope	2
15	Bashkues Gize me Fllanxha (Vario) DN 100 mm Pn 16 me kend 10grade	cope	1
16	Brryl Bashkues PP dn 32 pn 16	cope	50
17	Brryl Bashkues PP dn 40 pn 16	cope	20

18	<i>Brryl Bashkues PP dn 50 pn 16</i>	<i>cope</i>	20
19	<i>Brryl Bashkues PP dn 63 pn 16</i>	<i>cope</i>	30
20	<i>Brryl Bashkues PP dn 75 pn 16</i>	<i>cope</i>	5
21	<i>Brryl Bashkues PP dn 90 pn 16</i>	<i>cope</i>	30
22	<i>TI PP dn 25 pn 16</i>	<i>cope</i>	20
23	<i>TI PP dn 32 pn 16</i>	<i>cope</i>	20
24	<i>TI M PP dn 75x2 1/2 pn 16</i>	<i>cope</i>	5
25	<i>TI M PP dn 90x3 pn 16</i>	<i>cope</i>	5
26	<i>TEE Gize DN 160*80*160 mm me dy anaza bronxi dhe Dalja e mesit me Fllanxe pn 16</i>	<i>cope</i>	1
27	<i>TEE Gize DN 160*160*160 mm me tre anet unaza bronxi pn 16</i>	<i>cope</i>	2
28	<i>TEE Gize 90*90*90 me tre anet unaza bronxi pn 16</i>	<i>cope</i>	2
29	<i>Mufta Bashkuese PP dn 25*32 pn 16</i>	<i>cope</i>	50
30	<i>Mufta Bashkuese PP dn 32*40 pn 16</i>	<i>cope</i>	50
31	<i>Mufta Bashkuese PP dn 40*50 pn 16</i>	<i>cope</i>	20
32	<i>Mufta Bashkuese PP dn 50*63 pn 16</i>	<i>cope</i>	20
33	<i>Mufta Bashkuese PP dn 63*75 pn 16</i>	<i>cope</i>	20
34	<i>Mufta Bashkuese PP dn 90*63 pn 16</i>	<i>cope</i>	10
35	<i>Mufta Bashkuese PP dn 63*32 pn 16</i>	<i>cope</i>	40
36	<i>Tube pe 100 dn 20 pn 16</i>	<i>ML</i>	1000
37	<i>Tube pe 100 dn 25 pn 10</i>	<i>ML</i>	1000
38	<i>Tube pe 100 dn 25 pn 16</i>	<i>ML</i>	1000
39	<i>Tube pe 100 dn 32 pn 10</i>	<i>ML</i>	1000
40	<i>Tube pe 100 dn 32 pn 16</i>	<i>ML</i>	1000
41	<i>Tube pe 100 dn 40 pn 10</i>	<i>ML</i>	1000
42	<i>Tube pe 100 dn 40 pn 16</i>	<i>ML</i>	1000
43	<i>Tube pe 100 dn 50 pn 16</i>	<i>ML</i>	800
44	<i>Tube pe 100 dn 63 pn 10</i>	<i>ML</i>	800
45	<i>Tube pe 100 dn 63 pn 16</i>	<i>ML</i>	1000
46	<i>Tube pe 100 dn 75 pn 16</i>	<i>ML</i>	300
47	<i>Tube pe 100 dn 110 pn 16</i>	<i>ML</i>	200
48	<i>Tube pe 100 dn 125 pn 16</i>	<i>ML</i>	60
49	<i>Tube pe 100 dn 140 pn 16</i>	<i>ML</i>	36
50	<i>Tube pe 100 dn 160 pn 16</i>	<i>ML</i>	12
51	<i>Tube pe 100 dn 180 pn 16</i>	<i>ML</i>	6
52	<i>Tube pe 100 dn 200 pn 16</i>	<i>ML</i>	12
53	<i>Tube pe 100 dn 250 pn 16</i>	<i>ML</i>	6
54	<i>Tube Korroget dn 110</i>	<i>ML</i>	500
55	<i>Tube Korroget dn 160</i>	<i>ML</i>	700
56	<i>Tube Korroget dn 200</i>	<i>ML</i>	700

57	<i>Tube Korroget dn 250</i>	<i>ML</i>	400
58	<i>Tube Korroget dn 315</i>	<i>ML</i>	100
59	<i>Tube Korroget dn 400</i>	<i>ML</i>	36
60	<i>Tube Korroget dn 600</i>	<i>ML</i>	12
61	<i>Tube Korroget dn 1000</i>	<i>ML</i>	12
62	<i>Tube PVC dn 100</i>	<i>ML</i>	100
63	<i>Tube PVC dn 140</i>	<i>ML</i>	100
64	<i>Tube PVC dn 160</i>	<i>ML</i>	100
65	<i>Tube PVC dn 200</i>	<i>ML</i>	100
66	<i>Brryl PVC dn 100</i>	<i>cope</i>	6
67	<i>Brryl PVC dn 140</i>	<i>cope</i>	2
68	<i>Brryl PVC dn 160</i>	<i>cope</i>	4
69	<i>Brryl PVC dn 200</i>	<i>cope</i>	4
70	<i>Saraqineska plastike 1/2 mashkull</i>	<i>cope</i>	50
71	<i>Saraqineska Bronxi dn 1/2</i>	<i>cope</i>	500
72	<i>Saraqineska Bronxi dn 3/4</i>	<i>cope</i>	100
73	<i>Saraqineska Bronxi dn 1"</i>	<i>cope</i>	30
74	<i>Saraqineska Bronxi dn 1*1/2</i>	<i>cope</i>	10
75	<i>Saraqineska Bronxi dn 1*1/4</i>	<i>cope</i>	15
76	<i>Saraqineska Bronxi dn 2"</i>	<i>cope</i>	30
77	<i>Saraqineska Bronxi dn 2.5"(75)</i>	<i>cope</i>	6
78	<i>Saraqineska Bronxi dn 3"</i>	<i>cope</i>	5
79	<i>Saracineske + Set me fllanxa dn 50</i>	<i>cope</i>	2
80	<i>Saracineske + Set me fllanxa dn 80</i>	<i>cope</i>	2
81	<i>Saracineske + Set me fllanxa dn 100</i>	<i>cope</i>	2
82	<i>Reduksion Xingato 2*1</i>	<i>cope</i>	10
83	<i>Reduksion Xingato 2*3</i>	<i>cope</i>	5
84	<i>Manikota Xingato 2-1/2</i>	<i>cope</i>	10
85	<i>Tapa plastike 1/2 Femer</i>	<i>cope</i>	100
86	<i>Tapa Plastike 1/2 Mashkull</i>	<i>cope</i>	200
87	<i>Tapa Plastike 3/4 Femer</i>	<i>cope</i>	100
88	<i>Tapa Plastike 3/4 Mashkull</i>	<i>cope</i>	100
89	<i>Tapa Xingato 1/2</i>	<i>cope</i>	300
90	<i>Tapa Xingato 3/4</i>	<i>cope</i>	300
91	<i>Zgjatues xingato 20*1/2 Femer mashkull 3 CM</i>	<i>cope</i>	200
92	<i>Zgjatues xingato 25* 3/4 Femer Mashkull 3CM</i>	<i>cope</i>	100
93	<i>Fasheta (kavallota) PP dn 180*2 pn 16</i>	<i>cope</i>	5
94	<i>Fasheta (kavallota) PP dn 200*2 pn 16</i>	<i>cope</i>	2
95	<i>Fasheta (kavallota) Gize dn 90 x 1</i>	<i>cope</i>	5
96	<i>Fasheta (kavallota) Gize dn 125 x 1 1/2</i>	<i>cope</i>	10
97	<i>Fasheta (kavallota) Gize dn 180 x 2</i>	<i>cope</i>	6
98	<i>Fasheta Riparuese Inoks dn 63 pn 16</i>	<i>cope</i>	5

99	<i>Fasheta Riparuese Inoks dn 75 pn 16</i>	<i>cope</i>	5
100	<i>Fasheta Riparuese Inoks dn 90 pn 16</i>	<i>cope</i>	4
101	<i>Fasheta Riparuese Inoks dn 110 pn 16</i>	<i>cope</i>	5
102	<i>Fasheta Riparuese Inoks dn 125 pn 16</i>	<i>cope</i>	10
103	<i>Fasheta Riparuese Inoks dn 140 pn 16</i>	<i>cope</i>	4
104	<i>Fasheta Riparuese Inoks dn 160 pn 16</i>	<i>cope</i>	4
105	<i>Fasheta Riparuese Inoks dn 180 pn 16</i>	<i>cope</i>	4
106	<i>Fasheta Riparuese Inoks dn 200 pn 16</i>	<i>cope</i>	10
107	<i>Fasheta Riparuese Inoks dn 225 pn 16</i>	<i>cope</i>	5
108	<i>Fasheta Riparuese Inoks dn 250 pn 16</i>	<i>cope</i>	2
109	<i>Fasheta Riparuese Inoks dn 300 pn 16</i>	<i>cope</i>	4
110	<i>Fasheta Riparuese Inoks dn 400 pn 16</i>	<i>cope</i>	4
111	<i>Manikota Elektrofuzive dn 75 pn 16</i>	<i>cope</i>	6
112	<i>Fashete Elektrofuzive DN 110*1 me dalje Bronxi</i>	<i>cope</i>	6
113	<i>Manikota Elektrofuzive dn 125 pn 16</i>	<i>cope</i>	5
114	<i>Manikota Elektrofuzive dn 160 pn 16</i>	<i>cope</i>	5
115	<i>Manikota Elektrofuzive dn 200 pn 16</i>	<i>cope</i>	10
116	<i>Manikota Elektrofuzive dn 225 pn 16</i>	<i>cope</i>	10
117	<i>kapake Plastike fi 400</i>	<i>cope</i>	30
118	<i>Kaseta Metalike 30*40*10 trashesia Imm</i>	<i>cope</i>	30
119	<i>Puceta Plastike Matesash</i>	<i>cope</i>	150
120	<i>Tube pl ppr DN25</i>	<i>ML</i>	50
121	<i>Tube pl ppr DN 32</i>	<i>ML</i>	100
122	<i>Tube pl ppr DN40</i>	<i>ML</i>	30
123	<i>Tube Llastiku(markuc) 1/2</i>	<i>ML</i>	50
124	<i>Tube Llastiku(markuc) 3/4</i>	<i>ML</i>	50
125	<i>Hekur fi 6 (L=12M)</i>	<i>cope</i>	40
126	<i>Hekur fi 8 (L=12M)</i>	<i>cope</i>	30
127	<i>Manikota PI me ngjitje lisho DN50</i>	<i>cope</i>	10
128	<i>Manikota PI me ngjitje lisho DN40</i>	<i>cope</i>	10
129	<i>Manikota PI me ngjitje lisho DN63</i>	<i>cope</i>	10
130	<i>Manikota plastike me fileto Meshkuj DN20 x 1/2</i>	<i>cope</i>	50
131	<i>Manikota plastike me fileto Femra DN20 x 1/2</i>	<i>cope</i>	50
132	<i>Manikota plastike me fileto Meshkuj DN25 x3/4</i>	<i>cope</i>	50
133	<i>Manikota plastike me fileto Femra DN25 x 3/4</i>	<i>cope</i>	50
134	<i>Manikota plastike me fileto Meshkuj DN32x1</i>	<i>cope</i>	30
135	<i>Manikota plastike me fileto Femra DN32x1</i>	<i>cope</i>	30
136	<i>Manikota plastike me fileto Meshkuj DN40x 1 1/4</i>	<i>cope</i>	20
137	<i>Manikota plastike me fileto Femra DN40x 1 1/4</i>	<i>cope</i>	20
138	<i>Hollandez 3/4 xingato</i>	<i>cope</i>	20
139	<i>Hollandez xingato 2"</i>	<i>cope</i>	5
140	<i>Fllanxhe Adaptor dn 63 Gize</i>	<i>cope</i>	2

141	Fllanxhe Adaptor dn 75 Gize	cope	2
142	Fllanxhe Adaptor dn 90 Gize	cope	2
143	Fllanxhe Adaptor dn 110 Gize	cope	2
144	Fllanxhe Adaptor dn 125 Gize	cope	2
145	Fllanxhe Adaptor dn 140 Gize	cope	2
146	Fllanxhe Adaptor dn 160 Gize	cope	2
147	Fllanxhe Adaptor dn 180 Gize	cope	2
148	Fllanxhe Adaptor dn 225 Gize	cope	3
149	Fllanxhe Adaptor dn 250 Gize	cope	3
150	Fllanxhe Adaptor dn 300 Gize	cope	3
151	Fllanxhe Adaptor dn 400 Gize	cope	3
152	Matesa mekanik + Buketona 1"	cope	26
153	Prixhioner M 8	Ml	5
154	Prixhioner M 10	Ml	5
155	Prixhioner M 12	Ml	5
156	Prixhioner M 14	Ml	5
157	Prixhioner M 16	Ml	5
158	Gomina Plastike 3/4	pako	5
159	Buketona 1/2	Cifte	200
160	Buketona 3/4	Cifte	100
161	Elektroda Inoksi 2.5	Kg	12
162	Elektroda 3.2	Kg	12
163	Elektroda 2.5	Kg	12
164	Fllanxhe Metalike Dn 100 pn 10 me 8 Vrima	cope	4
165	Fllanxhe Metalike Dn 160 Pn 10 me 8 Vrima	cope	2
166	Fllanxhe Metalike Dn 250 Pn 10 me 8 Vrima	cope	2
167	Kapak Gize EN124 Fi 400	cope	30
168	Kapak Gize EN124 Fi 600	cope	20

Afatet e lëvrimit: brenda 30 diteve nga lidhja e kontrates

III.2.5. Në procesverbalin “Për Argumentimin dhe Miratimin e Specifikimeve Teknike dhe Kriteve Për Kualifikim”, të publikuar në SPE autoriteti kontraktor ka argumentuar vendosjen e kriterit kualifikues të sipërpërmendur dhe të specifikimeve teknike të produkteve objekt prokurimi, si më poshtë vijon:

*OE ofertues duhet të paraqesë **Autorizim Prodhuesi** ose **distributor zyrtar** për mallrat objekt prokurimi. Në rast paraqitje të autorizimit nga distributori i autorizuar, operatori ekonomik duhet të provojë me dokument, lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.*

Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,

Autorizimi i prodhuesit ose nga distributor i autorizuar është kërkuar me qëllim që të konfirmojë statusin aktual të OE dhe të sigurojë institucionin (AK) që kompanite e duhura ofrojnë mallrat dhe shërbimet e kërkuara, pasi në treg mund të ketë tregetare që mund të blejnë nga të tretet dhe kjo nuk i ben të autorizuar për procedurën e prokurimit.

III.2.6. Neni 2 “Qëllimi” i ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se:

Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.2.7. Neni 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se:

1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.2.8. Neni 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.2.9. Në nenin 77, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.2.10. Në nenin 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” pika 3, e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit

publik” i ndryshuar, parashikohet se: “ 3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”.

III.2.11. Neni 40, pika 6, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose

b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose

c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuara, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

III.2.12. Në nenin 36 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se:

“Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet. Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. *Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.*

3. *Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:*

a) *kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;*

b) *standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;*

c) *kërkesave në terma funksionale sipas shkronjës "a", referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës "b" të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;*

ç) *të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".*

4. *Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".*

5. *Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "b" të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.*

6. *Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "a" të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor."*

III.2.13. *Në lidhje me kërkesën e autoritetit kontraktor për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit për artikujt e përcaktuar në pikën 2.3.5 të kapacitetit teknik në kriteret e veçanta të kualifikimit, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të ndalet në një test proporcionaliteti, së pari, nëse kërkesa në fjalë është e përshatshme për arritjen e synimit të kërkuar dhe së dyti,*

nëse kërkesa në fjalë shkon përtej asaj, se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin. KPP gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor harton dokumentet e tenderit, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

III.2.14. Për sa më sipër, KPP nisur nga parashtrimet e operatorit ekonomik ankimues, dhe procesverbali për argumentimin e kriterëve për kualifikim dhe specifikimeve teknike, gjykon se autoriteti kontraktor ka dështuar në argumentimin pse paraqitja e autorizimit të prodhuesit/distributorit zyrtar është e përshtatshme për arritjen e synimit të kërkuar dhe se kjo kërkesë nuk shkon përtej asaj, se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin. Nisur nga procesverbali për argumentimin e kriterëve për kualifikim dhe specifikimeve teknike, autoriteti kontraktor në asnjë rast nuk ka justifikuar pse është pikërisht paraqitja e autorizimit të prodhuesit/distributorit zyrtar, dokumenti i cili i jep garancinë e vetme për sigurimin e produktit të kërkuar në kohë dhe cilësi dhe se kjo nuk mund të realizohet nga dokumente të tjerë të cilët autoriteti kontraktor i ka kërkuar në kriteret kualifikuese për të vërtetuar përmbushjen e specifikimeve teknike. Nga verifikimi i dokumenteve të tenderit të hartuara nga autoriteti kontraktor, KPP gjykon, se informacionin në lidhje me cilësinë e artikujve dhe mundësinë e sigurimit të tyre në kohë për përmbushjen me sukses të kontratës, autoriteti kontraktor e siguron edhe përmes përmbushjes nga operatori ekonomik ankimues të kriterit për paraqitjen e katalogut/skedës teknike ku përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për secilin artikull. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se kërkesa e autoritetit kontraktor që: “OE ofertues duhet të paraqesë **Autorizim Prodhuesi ose distributor zyrtar** për mallrat objekt prokurimi. Në rast paraqitje të autorizimit nga distributori i autorizuar, operatori ekonomik duhet të provojë me dokument, lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar” është një kërkesë e ekzagjeruar dhe në kundërshtim me qëllimin e lex specialis si dhe rregullat e prokurimit publik të cilat kanë si synim nxitjen e konkurrencës dhe sigurimin e një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomik pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, prandaj autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për heqjen e këtij kriteri për kualifikim nga dokumentet e tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Komisioni gjykon se, kërkesa për autorizim prodhuesi është një kërkesë e pajustificuar nga autoriteti kontraktor. Komisioni thekson se për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet se mallrat objekt prokurimi të jenë në përputhje me specifikimet teknike dhe nevojat reale, për ekzekutimin e kontratës në mënyrë të suksesshme, në respekt të nenit 77 “Kërkesat

për kualifikim”, pika 4, të ligjit nr.162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndyshuar dhe nenit 40, pika 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, parashikon se: “3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në këtë kuptim, Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin e mësipërm në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës objekt shqyrtimi.

III.2.15. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.2.16. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se kriteret për kualifikim dhe specififikimet teknike vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specififikimet teknike janë lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjestim me objektin dhe natyrën e kontratës së prokurimit. Në rastin konkret, Komisioni gjykon se, është e nevojshme të ndalet në një interpretim të zgjeruar të dispozitës së lex specialis, mbi mënyrën e hartimit të specifikimeve teknike. Komisioni i

Prokurimit Publik, gjykon, se autoritetet kontraktore në hartimin e specifikimeve teknike, ***krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin, se hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse duke krijuar kushte për konkurrin të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve,*** duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës. Për këtë qëllim ligjvënësi ka parashikuar, se këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Ligjvënësi ka parashikuar qartësisht në nenin 36 pika 1 paragrafi 4 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, se duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përrjashtojnë nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit qofshin këta kombëtar apo ndërkombëtarë. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt. E rëndësishme është që në asnjë rast, specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/malli/shërbimi që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm. KPP gjykon, se parashikimet e mësipërme duhet të zbatohen në të gjithë procedurat e prokurimit, me përjashtim të rasteve ku vetë ligji i prokurimit publik, parashikon një përjashtim të tillë. Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson punët/mallrat/shërbimet si të pranueshme për funksionet e kërkuara. Gjithashtu, duke u ndalur në pikën 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, KPP-ja gjykon se, ligjvënësi ka parashikuar katër metoda kryesore në hartimin e specifikimeve teknike. Metoda e parë lidhet me kërkesat funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën. ***Metoda e dytë mbështet në standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve.*** Metoda e tretë përfshin kërkesat në termat funksional sipas metodës së parë, por referuar specifikimeve teknike të hartuara sipas metodës së dytë, si një mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale, si edhe të të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”. Në hartimin e specifikimeve teknike dhe kjo duhet pasqyruar

edhe në dokumentet e tenderit. Nga interpretimi teleologjik (qëllimi i normës juridike), arrijmë në përfundim, se e rëndësishme është që përmes specifikimeve teknike, autoriteti kontraktor të mundësojë një konkurrim të drejtë, të hapur, e gjithëpërfshirës, të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, si edhe të mos drejtohen drejt një produkti të vetëm të ofruar nga një operator i vetëm ose nga një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë. Gjithashtu referuar nenit 42 të Direktivës 24/2014 “Për prokurimin publik” KE, parashikohet se: “*Specifikimet teknike siç përcaktohen në pikën 1 të Shtojcës VII do të përcaktohet në dokumentet e prokurimit. Specifikimi teknik përcakton karakteristikat, që kërkohen për një punë, shërbim ose furnizim*” Gjithashtu, në nenin 4 paragrafi 38 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet “Specifikime teknike” janë: a) në rast të prokurimit publik të punëve, përmbledhje e të dhënave teknike të përfshira në dokumentacionin e tenderit, me të cilat janë përkufizuar karakteristikat e nevojshme të materialeve, prodhimeve ose mallrave për t’u përshtatur me përdorimin që i duhet autoritetit ose entit kontraktor. Këto karakteristika përfshijnë ndikimin mbi mjedisin jetësor dhe ndikime klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe procedurat për sigurim të cilësisë, terminologjinë, simbolet, metodat e testimit, paketimit, shënimit dhe etiketimit, si dhe udhëzime për shfrytëzim, proceset dhe metodat e prodhimit të objektit. Gjithashtu, këto karakteristika, përfshijnë rregulla nga projekti dhe rregulla për vlerësim të shpenzimeve, kushte për testim, për inspektim dhe për pranim të punëve të realizuara, metoda ose teknika ndërtimore, si dhe të gjitha kushtet e tjera teknike, të cilat autoriteti ose enti kontraktor ka të drejtë t’i përcaktojë në pajtim me rregullat e përgjithshme dhe të veçanta në lidhje me objektin dhe materialet ose pjesët e përfshira; b) në rast të prokurimit publik të mallrave ose shërbimeve, specifikimi me të cilin përkufizohen karakteristikat e prodhimit ose shërbimit, siç janë niveli i cilësisë, ndikimi mbi mjedisin jetësor dhe ndikimet klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe arritshmëri për persona me aftësi të kufizuara dhe vlerësim të përputhshmërisë, niveli i realizimit, shfrytëzim i prodhimit, siguri ose dimensione, duke i përfshirë edhe kërkesat relevante për produktin në raport me emërtimin me të cilin shitet, terminologjinë, simbolet, testimet dhe metodat për testim, paketimin, shënimin dhe etiketimin, si dhe udhëzime për përdorim, proceset dhe metodat e prodhimit në secilën fazë të jetëgjatësisë së mallrave dhe shërbimeve, si dhe procedura për vlerësim të përputhshmërisë.”

Ndërsa, në pikën 1 të Shtojcës VII të Direktivës parashikohet se: “*specifikim teknik*” nënkupton njëherë nga sa vijon: b) në rastin e kontratave të furnizimit publik ose shërbimeve, një specifikim në një dokument që përcakton karakteristikat e kërkuara të një produkti ose një shërbimi, siç janë nivelet e cilësisë, nivelet e performancës mjedisore dhe klimatike, modelimi për të gjithë kërkesat (përfshirë aksesin e personave me aftësi të kufizuara) dhe vlerësimin e konformitetit, performancën, përdorimin e këtij produkti, siguria ose dimensionet, përfshirë kërkesat që lidhen me produktin në lidhje me emrin nën të cilin produkti shitet, terminologji, simbole, metodat e provës, paketimin, markimin dhe etiketimin, përdorues-udhëzimet, proceset e prodhimit dhe metodat në çdo fazë të ciklit jetësor të furnizimit ose shërbimit dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit; Në vendimin e GJED Çështja C-368/10 “Komisioni European vs. Mbretëria e Holandës” *inter alia* dhe *mutatis mutandis* është arsyetuar se: “*Specifikimet teknike të hartuara nga blerësit publik duhet të lejojnë që prokurimet publike të hapen në konkurrencë. Për këtë qëllim, duhet të jetë e mundur të dorëzohen tenderë që pasqyrojnë larminë e zgjidhjeve teknike. Prandaj, duhet të jetë e mundur të hartohen specifikimet teknike*

për sa i përket performancës funksionale dhe kushteve, dhe kur referimi bëhet në standardin Evropian ose, në mungesë të tij, ndaj standardit kombëtar, ofertuesit bazuar në marrëveshje ekuivalente duhet të merren në konsideratë nga autoritetet kontraktuese.” Gjithashtu, nga ana tjetër, Komisioni i Prokurimit Publik gjen me vend të sqarojë, se është në të drejtë të operatorëve ekonomikë, që në respekt të nenit 109 e vijues të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” të parashtrojnë pretendime mbi modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit përfshirë edhe specifikimet teknike të procedurës, brenda afatit të përcaktuar në nenin 110 pika 1 të ligjit. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se ligji 162/2020 “Për prokurimin publik” është përafuar pjesërisht edhe me Direktivën e Këshillit 89/665/KEE, datë 21 dhjetor 1989 “*Mbi koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative në lidhje me zbatimin e procedurave të rishikimit për dhënien e kontratave të furnizimit publik dhe punëve publike*”, e ndryshuar. Numri CELEX 31989L0665, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, nr.395, datë 30.12.1989, fq. 33. Në dritën e direktivës, ekzistojnë dy kushte të përmendura në lidhje me qasjen në procedurat e rishikimit (neni 1 (3): “*Procedurat e rishikimit duhet të jenë në dispozicion (...) të paktën për çdo person që ka ose ka pasur interes për të marrë një kontratë të veçantë dhe që ka qenë ose rrezikon të dëmtohet nga një shkelje e pretenduar*”.

Në nenin 94 pika 1 të Vendimit nr.285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar parashikohet se: “*1. Çdo operator ekonomik, i cili ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi sipas LPP, dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga veprimet ose mosveprimet e autoritetit/entit kontraktor, për të cilat pretendon se janë në kundërshtim me ligjin, ka të drejtë të ankohet pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.*” Në interpretim literal, sistematik dhe teologjik me synim vendojsen në pah të *ratio legis*, mbështetur edhe në parimin e së drejtës se *ratio legis est anima legis*, (*qëllimi i ligjit është edhe shpirti i ligjit*), interesi i ligjshëm i operatorëve për të paraqitur ankim pranë autoritetit kontraktor si edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik duhet që operatori ekonomik të jetë dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i marrë nga autoriteti kontraktor në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik. KPP thekson se, fakti se një ose disa produkte të një ose disa prodhues vendas ose ndërkombëtarë nuk përmbushin minimumin e specifikimeve teknike të përcaktuara nga ana e autoritetit kontraktor nuk përbën një kusht *sine qua non* se specifikimet teknike janë hartuar në kundërshtim me ligjin për prokurimin publik. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në rastin konkret ndodhemi në kuptimin klasik të barrës së provës referuar parimit juridik *onus probandi incubit actor* (barra e provës i bie kërkuesit) si edhe në përputhje me nenin 82 pika 1 të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, në të cilin parashikohet se: “*në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj*”. Pra, operatorët ekonomikë duhet të argumentojnë/dëshmojnë se specifikimet teknike të hartuara nga autoriteti kontraktor janë në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik dhe jo mbi faktin se këto të fundit nuk plotësohen nga një ose disa prodhues kombëtar/ndërkombëtar me reputacion. Nga ana tjetër, Komisioni i Prokurimit Publik, nënvizon se autoriteti kontraktor në hartimin e specifikimeve teknike të procedurës së prokurimit duhet t’i përmbahet *stricto-sensu* vetëm metodave të parashikuara në nenin 36 të ligjit për prokurimin publik.

Gjithashtu nga shqyrtimi i procesverbalit “Për Argumentimin dhe Miratimin e Specifikimeve Teknike dhe Krieteve për Kualifikim” të publikuar nga autoriteti kontraktor në sistemin e prokurimeve elektronike, Komisioni konstaton se autoriteti përfitues Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Pogradec SHA nuk ka argumentuar teknikisht përcaktimin e specifikimeve teknike të sipërpërmendura të artikujve objekt prokurimi. Nga shqyrtimi i pretendimeve të ankimesit “Alpha Solutions Group” SHPK në lidhje me specifikimet teknike të artikujve objekt prokurimi, Komisioni konstaton se pretendimet e tij lidhen me detajimin e tyre të cilat të referojnë vetëm tek një prodhues, duke cënuar konkurrencën dhe diskriminuar rradhët e operatorëve ekonomikë, prandaj KPP i gjykon të drejta kërkesat e operatorit ekonomik ndaj autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për të hapur dipazonin në vendosjen e parametrave që përfshijnë një minimum dhe maksimum, duke shmangur në këtë mënyrë paramentrat fikse por pa cenuar funksionalitetin e pasjisjeve. Komisioni gjykon se AK në hartimin e specifikimeve teknike duhet të jetë i kujdesshëm në vendosjen e parametrave më të rëndësishëm për artikujt objekt prokurimi dhe të jenë në proporcion me elementët e procedurës së prokurimit pasi specifikimet teknike orientojnë operatorët drejt markave të caktuara duke kufizuar konkurrencën.

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimes qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Alpha Solutions Group” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-77670-02-27-2026, me objekt “Blerje materiale hidraulike, tubo, pvc, pe, Corrogete”, me fond limit: 9,997,619 (nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e nëntëmbëdhjetë) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 19.03.2026, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Pogradec.
2. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Alpha Solutions Group” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-77670-02-27-

2026, me objekt “Blerje materiale hidraulike, tubo, pvc, pe, Corrogete”, me fond limit: 9,997,619 (nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e nëntëmbëdhjetë) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 19.03.2026, nga autoriteti kontraktor, Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Pogradec.

3. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.
4. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatorët ekonomikë ankimues “Alpha Solutions Group” SHPK.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

